



133


REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Rregj. Them. 3303

Data e rregjistrimit 29.04.2014

№ Vendimit. 3302

Data e vendimit 08.09.2014



VENDIM
NE EMER TE REPUBLIKES

Gjykata Administrative e Apelit, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët:

Lindita SINANAJ	Kryesuese
Artur MALAJ	Anëtar
Altina NASUFI	Anëtare

me sekretare gjyqësore *Visela Kashari*, në Tiranë, sot më datë 08.09.2014, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi çështjen administrative, që i përket palëve:

PADITËS: *Erti Korcari*, i biri i Vladimirit dhe i Bukuroshes, i datëlindjes 26.12.1988, lindur dhe banues në Cakran, Fier.

E PADITUR: *-Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.*
-Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier.

OBJEKTI: Detyrimin për pagimin e dëmshpërblimit për largimin nga puna në mënyrë të menjëherëshme dhe pa shkaqe të justifikuara me:
-Pagën e 1 viti pune për zgjidhje të menjëherëshme dhe të pajustificuar të Kontratës së Punës, neni 155 i Kodit

të Punës.

-Pagën e 2 muajve për mosrespektim të afatit të njoftimit, sipas nenit 143 të Kodit të Punës.

-Pagën e 2 muajve për moszbatim të procedurës sipas nenit 144 të Kodit të Punës.

BAZA LIGJORE: Nenet 143; 144; 152; 153; 155 të Kodit të Punës, Ligji Nr. 9920, datë 18.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” VKM Nr. 1184, datë 20.08.2008 “Për përcaktimin e procedurave për rekrutimin dhe emërimin, të afateve të kalimit nga një nivel më i ulët në një nivel më të lartë karriere dhe për marrjen e masave disiplinore për punonjësit e Administratës Tatimore Qëndrore”, Ligjin Nr. 49/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative”

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi pretendimet e parashtruara në ankim nga pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, që kërkon:

- ndryshimin e vendimit Nr. 133, datë 13.02.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, dhe rrëzimin e kërkesë-padisë së paditësit Erti Korcari.

dhe bisedoi çështjen në tërësi:

VËREN

Në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 29.04.2014 është regjistruar ankimi i paraqitur nga pala e paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, kundër vendimit Nr.133, datë 13.02.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, bazuar në nenet 442, 443 e vijues të

K.Pr.Civile dhe nenin 48 të Ligjit Nr. 49/2012 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative". Ky ankim fillimisht është paraqitur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, e cila ka bërë verifikimin e kushteve për pranimin e ankimit të paraqitur. Me vendimin e datës 28.03.2014 ka vendosur pranimin e ankimit duke dërguar në Gjykatën Administrative të Apelit, ankimin së bashku me aktet e njoftimit të ankimit, si dhe dosjen e gjykimit për shqyrtim.

Nga aktet e dosjes së gjykimit rezulton se në datën 20.12.2013, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, është rregjistruar padia objekt gjykimi. Pas shqyrtimit të çështjes, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë me vendimin Nr. 133, datë 13.02.2014 ka vendosur: "*Të pranojë pjesërisht kërkesë-padinë si të bazuar në prova dhe në ligj. Të rrëzojë kërkesën për dëmshpërblim për zgjidhjen e menjëherëshme të kontratës së punës pa shkaqe të justifikuara, si të pabazuar në prova dhe në ligj. Të detyrojë të paditurin të dëmshpërblejë paditësin për dëmin e shkaktuar nga mosrespektimi i afatit të njoftimit, duke i akorduar paditësit pagën e 1 muaji. Të detyrojë të paditurin të dëmshpërblejë paditësin për dëmin e shkaktuar nga mosrespektimi i procedurës për zgjidhjen e kontratës, duke i akorduar paditësit pagën e 2 muajve. Të detyrojë të paditurin të dëmshpërblejë paditësin përfundimisht me 3 muaj pagë. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë brenda 15 ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit për palët në mungesë"*

Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, ka paraqitur ankim pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, duke parashtruar këto shkaqe:


- ✓ Vendimi i gjykatës është i pabazuar në ligj dhe në prova dhe për këtë arsye duhet të ndryshohet dhe padia duhet të rrëzohet plotësisht.
- ✓ DPT-Tiranë, ka vepruar brenda kompetencave ligjore të parashikuara nga Ligji Nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH" dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe Kodit të Punës.

Për sa më sipër pala e paditur ka kërkuar ndryshimin e vendimit Nr. 133, datë 13.02.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe rrëzimin tërësisht të padisë.

Faktet e parashtruara para gjykatës:

Paditësi ka qënë në marrëdhënie pune me palën e paditur DPT-Tiranë dhe DRT-Fier, në detyrën e Inspektorit të Parë në Sektorin e Përpunimit të Deklaratave, Vlerësimit dhe Rimbursimit, duke filluar nga data 05.06.2013. Kjo marrëdhënie pune ka përfunduar në datën 23.11.2013, me vendimin Nr. 2344, datë 19.11.2013 të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me motivacionin e përfundimit të periudhës së emërimit të përkohshëm dhe për moszhvillim të procedurave të konkurimit në kohë. Paditësi duke vlerësuar largimin e tij nga detyra si të kunderligjshëm i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi duke pretenduar se marrëdhënia e tij e punës janë rregulluar nga kontrate pune pa afat dhe se zgjidhja e kontratës së punës i është bërë në mënyrë të menjëherëshme, të njëanëshme dhe pa shkaqe të justifikuar.

Në analize të pretendimeve të parashtruara në kërkesepadi, të prapësimeve të paleve dhe provave e akteve shkresore të administruara në seance gjyqesore, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlore ka argumentuar se pala e paditur ka zgjidhur marrëdhënien e punës me paditësin në mënyrë të njëanëshme, të menjëherëshme e të pajustificuar e duke mos zbatuar procedurën dhe afatin e njoftimit të parashikuar në ligj. Nisur nga motivacioni i largimit nga puna të paditësit “përfundimit të periudhës së emërimit të përkohshëm dhe për moszhvillim të procedurave të konkurimit në kohë.” gjykata ka vlerësuar se nderprerja e marrëdhënieve të punës për paditësin është e pabazuar në ligj. Kjo për faktin se sipas njoftimit zyrtar të publikuar online në adresën e WebSite të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve www.tatime.gov.al, rezulton të jete publikuar “Njoftim për vënde të lira pune” njoftim ky i cili mban datën 31.10.2013, pra pas largimit të paditësit nga puna. Në këto kushte nuk ka arsye të ligjshme apo shkak të ligjshëm për t’u liruar nga detyra paditësi Erti Korcari, por ai si inspektor i përkohshëm pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, duhet të përfshihej në procedurën e konkurimit pranë DPT, në zbatim të Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, Ligjit Nr. 8549, datë 11.11.1999 “Për statusin e nëpunësit civil” i ndryshuar, VKM Nr. 231, datë 11.05.2000, VKM, Nr. 1184, datë 20.08.2008 “Për përcaktimin e procedurave për rekrutimin dhe emërimin, të afateve të kalimit nga një nivel më i ulët në një nivel më të lartë karriere dhe për marrjen e masave disiplinore për punonjësit e Administratës Tatimore Qëndrore ”




Nuk rezulton që ndaj paditësit të jetë marrë masë disiplinore nga ana e punëdhënsit gjatë kohës që ai ka qënë në marrëdhënie pune apo shkelje në punë të kryera nga ana e tij të konstatuara nga kontrolli i brendshëm apo i jashtëm i cili kontrollon ligjshmërinë e veprimtarisë së DRT-Fier. Gjykata e shkallës së parë ka cmuar se paditësi është në kushtet që parashikohen nga Kodi i Punës dhe dispozitat e tjera nënligjore në funksion të tij dhe ato që rregullojnë posacërisht efektet e prishjes së marrëdhënieve të punës midis paditësit dhe palës së paditur dhe duhet të perfitojë shperblimet nga pala e paditur për mosrespektim të afatit të njoftimit dhe të procedurës së njoftimit për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës. Kërkesa lidhur me demshperblimin për shkak të zgjidhjes së kontratës në mënyrë të menjehershme dhe pa shkaqe të justifikuara është gjetur nga gjykata e shkallës së parë si e pabazuar për shkak të periudhës së shkurtër të punës pranë palës së paditur dhe mundësisë për të gjetur punë për shkak të moshës së tij të re.

Vlerësimi i çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit

Së pari gjykata vlerëson të evidentojë kompetencën e saj për shqyrtimin e ankimit objekt i këtij gjykimi. Në referim të nenit 7 gërma "ç", nenit 10 paragrafi 2 gërma "a" dhe nenit 44 të ligjit Nr. 49/2012, kjo gjykatë ka kompetencën lëndore dhe funksionale për gjykimin e kësaj çështjeje.

Së dyti gjykata vlerëson të marrë në shqyrtim kushtet e pranueshmërisë së ankimit. Sikurse është referuar edhe më sipër në këtë vendim, rezulton që vendimi të jetë shpallur në datën 13.02.2014, në mungesë të palës së paditur e cila rezulton të ketë marrë vendimin në datën 05.03.2014. Ankimi nga pala e paditur, DRT Fier, është nisur nepermjet shërbimit postar në datën 19.03.2014 dhe është depozituar në gjykatë në datën 24.03.2014. Pra, ankimi nga pala e paditur është paraqitur brenda afatit pesëmbëdhjetë ditor të përcaktuar në nenet 443 paragrafi i parë dhe 444 paragrafi i parë të K.Pr.Civile. Po kështu, nuk rezulton të ekzistojnë kriteret penguese të parashikuara në nenin 45 të Ligjit Nr. 49/2012 që e bëjnë vendimin të paankimueshëm. Ankimi rezulton të jetë i plotë edhe në elementët e tjerë, si në elementët e formës edhe të përmbajtjes, lidhur me nënshkrimin nga pala që e ka paraqitur, tregimin e palëve ndërgjyqëse, vendimin kundër të cilit është paraqitur ankimi, apo kërkimet për të cilat është paraqitur ky ankimi. Për të gjitha sa më sipër gjykata cmon se ankimi i paraqitur kundër vendimit Nr. 133, datë 13.02.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlore, objekt gjykimi, duhet të pranohet për shqyrtim.



Se treti lidhur me pretendimet e parashtruara në ankim, nga pala e paditur, referuar fakteve të mësipërme, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se janë të pabazuara në ligj e prova. Në këto pretendime rezulton të jenë paraqitur të njëjtat fakte dhe argumenta që janë paraqitur edhe gjatë gjykimit të çështjes në shkallë të parë. Në shqyrtim të rrethanave të faktit e të ligjit kjo Gjykate vlerëson se nisur nga koha e fillimit të marrdhënieve të punës nga paditesi, data e ndërprerjes së këtyre marrdhënieve, si dhe në interpretim të neneve 140 e 141 të Kodit të Punës, kontrata e punës mes paditësit dhe të paditurit konsiderohet si kontratë pune me afat të pacaktuar. Kjo kontratë rezulton të jetë zgjidhur në mënyrë të menjehershme pa respektuar afatin e njoftimit sipas parashikimeve të nenit 143 të Kodit të Punës. Marrdhënia e punës për paditesin ka zgjatur mbi 5 muaj. Në këto kushte pala e paditur duhet të respektojë afatin e njoftimit, bazuar në nenin 143/1 të Kodit të Punës. Mosrespektimi i këtij afati ndërpret kontratën në mënyrë të menjehershme. Bazuar në nenin 155 të Kodit të Punës, pala e paditur detyrohet t'i japë paditësit pagën që do t'i takonte në rast se do të respektohej afati i njoftimit.

Duke marrë në analizë kriteret e nenit 153 të Kodit të Punës konstatohet se zgjidhja e marrdhënieve të punës për paditesin është bërë pa shkaqe të justifikuara. Kjo për faktin se nuk rezulton që marrdhënia e punës për paditesin të jetë rregulluar nga kontratë pune me afat të caktuar. Vendimi për emerimin e perkohshëm të paditësit nuk mund të vlerësohet si kontratë me afat të pacaktuar për arsye se në këtë vendim nuk është dhënë një afat konkret në përfundim të të cilit ndërpritet marrdhënia e punës për paditesin. Një konkluzion i tillë rezulton në referim të nenit 149 pika 1 të Kodit të Punës *“Kontrata me afat të caktuar përfundon në fund të kohës së parashikuar, pa zgjidhje paraprake.”*

Lidhur me procedurën e zbatuar për zgjidhjen e kontratës së punës, Gjykata konstaton se pala e paditur nuk e ka respektuar procedurën e detyrueshme për zgjidhjen e marrdhënieve të punës dhe në bazë të këtij konstatimi pala e paditur ka përgjegjësi pasurore për dëmshpërblimin e punëmarësit në respektim të kriterëve të nenit 144 pika 5 të Kodit të Punës.

Mbi bazën e përcaktimit të elementëve të mesipërme gjykata e shkallës së parë, drejt dhe në përputhje me kriteret e neneve 143, 144, 153 e 155 të Kodit të Punës ka disponuar edhe

detyrimin e palës së paditur lidhur me pagesat si dëmshpërblime që duhet të kryejë në favor të paditësit.

Edhe procedura e zhvillimit të këtij gjykimi rezulton të jetë në përputhje me dispozitat e ligjit Nr. 49/2012 dhe Kodit të Procedurës Civile. Nuk konstatohen shkelje si në procedurën e zhvillimit të gjykitimit edhe në procedurën e marrjes së vendimit nga gjykata e shkallës së parë. Për të gjitha sa më sipër kjo gjykatë vlerëson tërësisht të pabazuara në ligj e prova pretendimet e parashtruara në ankim nga pala e paditur. Per sa me sipër duke vlerësuar se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë në përputhje me rrethanat e faktit e të ligjit, referuar nenit 50 germa "b" të ligjit Nr. 49/2012, kjo gjykatë vlerëson se duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, në mbështetje të neneve 49 e 50 germa "b" të ligjit Nr. 49/2012 "Per organizimin edhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative",

VENDOSI

Lenien ne fuqi te vendimit Nr. 133, datë 13.02.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

Kundër vendimit lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 30 ditëve duke filluar ky afat nga dita e komunikimit të këtij vendimi.

Tirane më 08.09.2014.

ANETARE

Altina NASUFI

dv

ANETAR

Artur MALAJ

dv

Vertetohet njesia me origjinalin

KANCELARI

Leonard Strataj

KRYESUESE

Lindita SINANAJ

dv

